

# 2016

## Korpusi i Paqes, Shqipëri



## Raporti vjetor



Korpusi i Paqes, Shqipëri,

Rr. Besnik Sykja, Godina 2  
Hyrja 1 P.O.Box 8180, Tirana, Shqipëri



Peace  
Corps

Na kontaktoni:

Phone: (355) 4 2365 033  
email: [info@al.peacecorps.gov](mailto:info@al.peacecorps.gov)  
[www .peacecorps.gov/albania/](http://www.peacecorps.gov/albania/)  
[www .facebook.com/albania.peacecorps](https://www.facebook.com/albania.peacecorps)

## Ndërtojmë Ura Miqësie, që prej 1992

Gjatë vitit 2016, vullnetarë nga tre grupe të ndryshme i shërbyen komuniteteve në gjithë



Grupi i Shqipërisë 19



Grupi i Shqipërisë 18



Grupi i Shqipërisë 17



## Mesazh nga i Nderuari Donald Lu, Ambasador i SHBA, në Shqipëri

I dashur lexues,

Jam i kënaqur që po ofroj urimet më të përzemërta Programit të Korpusit të Paqes, në Shqipëri me rastin e përvjetorit të tij të 20-të. Edhe Një qind!

Programi i Korpusit të Paqes në Shqipëri ka pasur një histori krenare të partneritetit me sistemin shkollor shqiptar, me organizatat e shoqërisë civile dhe tani me pushtetin lokal në të gjithë vendin.

Duke udhëtuar në Shqipëri, unë vazhdimisht prekem nga historitë që dëgjoj nga vullnetarët tanë të Korpusit të Paqes. Ndonjëherë këto histori janë në lidhje me jetën e të rinjve që ata kanë prekur, por më shpesh ka të bëjë me aktet e mirësisë dhe mikpritjes që i ofrohet atyre nga shqiptarët që ata takojnë përditë. Ky vend është i famshëm për mikpritjen e tij dhe programi i Korpusit të Paqes ka përfituar nga kjo mikpritje legjendare për gati një çerek shekulli.

Kur unë isha vetë një nga vullnetarët e Korpusit të Paqes rreth 29 vjet më parë, kujtimet e mia të preferuara ishin nga njerëzit që kam takuar. Si një amerikan, ka shumë pak mënyra që mund të jetojsh në vende të tjera në qytete dhe fshatra të vogla. Unë kam besimin e patundur se programi i Korpusit të Paqes i ndihmon amerikanët për të qenë qytetarë më të mirë globalë dhe për të kuptuar botën në mënyra që ju mund t'i mësoni vetëm duke qenë pjesë e një komuniteti në një vend tjetër.

Faleminderit të gjithë shqiptarëve që mikpresin vullnetarët tanë të Korpusit të Paqes. Ne mezi presim për më shumë vite të miqësisë dhe partneritetit.

Sinqerisht,

Donald Lu



## Mesazh nga Kate Becker, Drejtore e Korpusit të Paqes në Shqipëri

Korpusi i Paqes në Shqipëri ka një histori domethënëse dhe tradita krenare të shërbimit në këtë vend. Ndihej e respektuar që jam Drejtoria për Shqipërinë prej vitit 2016, dhe që i jam bashkuar stafit të mrekullueshëm të Korpusit të Paqes dhe punoj krah për krah me 100 persona që shërbejnë si Vullnetarë të Korpusit të Paqes në mbarë vendin. Vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri punojnë krah për krah me partnerët e tyre shqiptarë në shkolla, organizata, dhe komunitete në mbarë vendin, si dhe me familje mikpritëse, homologë, dhe fëmijë. Ne punojmë së bashku për të pasur ndikim të qëndrueshëm dhe për të nxitur rritje dhe zhvillim individual ndërkohë që forcojmë kapacitetet organizative.

Këtë vit jam mahnitur nga larmia, përmasat, dhe shtrirja e ndikimit të Vullnetarëve dhe Homologëve të tyre shqiptarë. Ekzistojnë marrëdhënie të panumërta personale midis Vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe fëmijëve e të rriturve të cilët jetojnë dhe punojnë së bashku; marrëdhënie këto që kanë ndikime të mëdha. Ka edhe projekte, si: Klinika dentare e themeluar nga Kevin Bawden dhe Viktor Gjoka në Reps; themelimi i Skauteve për Vajza në Shqipëri nga Michelle Killingsworth, Hilary Richardson, dhe Iva Sinani; Kampi Pa Emër i themeluar nëntë vjet më parë nga Joe Deschenes dhe Alba Mana (Deschenes) në Librazhd. Ndikimet e të gjithë punës në mbarë vendin janë domethënëse dhe të rëndësishme.

Ju falënderojmë të gjithëve për ndihmën, kohën, dhe talentin që kaq bujarisht jepni për të mbështetur zhvillimin vendor dhe i bëni vullnetarët amerikanë të ndihen të mirëpritur dhe si në shtëpi, në vendin tuaj. Jemi krenarë që jemi Korpusi i Paqes në Shqipëri.

Në shërbim,

Kate M. Becker

## Misioni dhe qëllimet e Korpusit të Paqes

Korpusi i Paqes u themelua nga presidenti Xhon F. Kenedi në vitin 1961 për të krijuar mirëkuptimin dhe për të promovuar miqësinë midis amerikanëve dhe popujve të tjerë. Tre qëllimet e Korpusit të Paqes janë si vijon:

1. Mbështetja e popujve të interesuar në përmbushjen e nevojave të tyre për meshkuj dhe femra të trajnuara;
2. Promovimi i një imazhi më të mirë të amerikanëve te popujt të cilëve iu shërbehet;
3. Promovimi i një imazhi më të mirë të popujve të tjerë të amerikanët.

Korpusi i Paqes ndryshon jetët e anëtarëve të komuniteteve nëpër botë, si dhe të vullnetarëve. Vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë shfaqur angazhim në zhvillimin e nivelit bazë duke punuar dhe jetuar me shtetasit e vendeve ku shërbejnë, me qëllimin për të përmbushur Misionin e agjencisë për promovimin e paqes dhe miqësisë në botë.

Që prej vitit 1961, mbi 225,000 amerikanë kanë shërbyer në Trupat e Paqes në 141 vende.

Që prej vitit 1992, 746 Vullnetarë të Korpusit të Paqes kanë shërbyer në Shqipëri.



## Korpusi i Paqes në Shqipëri

Në vitin 1991, qeveria shqiptare i kërkoi SHBA-së të nisinin programin e Korpunit të Paqes në Shqipëri. Grupi i parë i vullnetarëve mbërriti në Shqipëri në vitin 1992 për të dhënë mësim anglisteje në shkollat e mesme dhe universitetet. Deri në 1997, 166 vullnetarë shërbyen në mbarë Shqipërinë. Gjatë këtij viti, SHBA-të evakuuan të gjithë vullnetarët e Trupave të Paqes për shkak të trazirave në vend asokohe.

Në vitin 2002 qeveria shqiptare i kërkoi SHBA-së të rinisin programin e Korpunit të Paqes në Shqipëri.

Që prej shtatorit të vitit 2003, 580 vullnetarë kanë punuar me bashki, Organizata joqeveritare, shkolla dhe institucione shëndetësore, në tre fusha të ndryshme: Zhvillimi Komunitar dhe Organizativ, Edukimi Shëndetësor dhe Mësimi i Gjuhës Angleze.

Programi i Korpunit të Paqes është i pranishëm në Shqipëri me kërkesën e qeverisë shqiptare dhe funksionon në bazë të një marrëveshjeje midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, e cila njihet rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit përfitues reciprok.

### Projekte:

- Mësimdhënia e gjuhës angleze si gjuhë e huaj;
- Zhvillimi Komunitar dhe Organizativ;
- Edukimi shëndetësor;

### Prioriteti programatik ndërsektorial:

- Lërimi vajzat të mësojnë;

## Partnerët tanë

Trupat e Paqes në Shqipëri funksionojnë në bazë të një Memorandumi Mirëkuptimi me qeverinë shqiptare.

Disa nga partnerët më të rëndësishëm janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Zhvillimit Urban
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
- Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Nderkombëtar (USAID)
- Ambasada Amerikane dhe American Corners
- Kombet e Bashkuara Shqipëri
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullatën (UNFPA)
- Projekti i Qeverisjes Vendore dhe Planifikimit

- Drejtoritë Arsimore Rajonale
- Zyrrat Arsimore
- Instituti i Zhvillimit Arsimor
- Shoqata e Mësuesve të Anglishtes
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Anglishtes
- Instituti i Shëndetit Publik
- Drejtoritë e Shëndetit Publik
- Kryqi i Kuq Shqiptar
- Dhoma e Tregtisë, Vlorë
- Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare – Gjyrokastër
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në Berat dhe Durrës
- 15 Bashki që përfshijnë:  
Krujë, Kuçovë, Berat, Fier, Shijak, Kavajë, Elbasan, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Ersekë, Lushnjë, Korçë, Mirditë dhe Roskovec;
- Organizata Jo-qeveritare Partnere që përfshijnë:  
Agropuka, World Vision, Food Bank, Youth in Free Enterprise, Lerda, Agjensitë Rajonale të Zhvillimit Korçë, Epoka e Re, Gjyrokastër Foundation, ARKA Center Shkodër, Mary Ward Loreto, Qendra Rinore Vlorë, Klinika Veterinare në Shkodër, World Connect, Darien Book Aid, Friends of Albania, Water Charity, Sidi Education.  
Shoqata Botërore e Vajzave Udhërrëfyese dhe Vajzave Skautiste.



## Vullnetarët tanë

Statistikat e vitit 2016

|                   |                                                                                                                                                             |
|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Gjithsej          | 149 vullnetarë kanë shërbyer në mbarë vendin.                                                                                                               |
| Program           | 73: Mësimdhënia e gjuhës angleze<br>48: Zhvillimi Komunitar dhe Organizativ<br>28: Edukimi Shëndetësor                                                      |
| Gjini             | 74: Femra<br>75: Meshkuj                                                                                                                                    |
| Moshë             | 62%: nga 23 deri 29 vjeç<br>18%: nga 30 deri 39 vjeç<br>20%: nga 40 deri 73 vjeç                                                                            |
| Shtetet e SHBA-së | Në vitin 2016, Vullnetarët përfaqësuan 33 nga 50 shtete dhe pjesa më e madhe e tyre vinin nga:<br>21% Kalifornia<br>7% Nju Jorku<br>5% Florida<br>5% Teksas |

## Stafi ynë



Ekipi i Korpusit të Paqes në Shqipëri përbëhet nga një staf i përkushtuar amerikanësh dhe shqiptarësh të cilët i mbështesin vullnetarët për të përmbushur qëllimet e shërbimit. Në fotografimin e mësipërme gjendet stafi me kohë të plotë vjetore i Korpusit të Paqes në Shqipëri.



Çdo vit ne punësojmë përkohësisht 20 kolegë, që luajnë një rol të rëndësishëm në trajnimin e Para-Shërbimit që i bëhet vullnetarëve





## Mësimi i gjuhës angleze



Konkursi Le të Shkruajmë!, Lushnjë, 2016

### Arritjet e 2016

Korpusi i Paqes bashkëpunon me kënaqësi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për promovimin e mësimi të gjuhës angleze në mbarë vendin. Vullnetarët janë vendosur në institucionet arsimore si më poshtë:

- 5 në universitete
- 4 në shkolla profesionale
- 25 në shkolla të mesme
- 15 në shkolla 9-vjeçare
- 4 në shkolla të bashkuara

#### Qëllimi 1: Përmirësimi i mësimdhënies

650 mësues

bashkëpunuan me vullnetarët për të zhvilluar së bashku programet mësimore, dhe burimet për t'u përdorur në klasë. Si rrjedhojë, mësuesit përmirësuan aftësitë e tyre në anglisht dhe fituan vetëbesim, si dhe u njohën metoda dhe praktika të reja në mësimdhënie.

#### Qëllimi 2: Rritja e suksesit të studentëve

5648 studentë

shfaqën përmirësime në aftësitë e tyre në anglisht bazuar te përmbajtjen e veprimtarive në klasë dhe/ose jashtëkurrikulare (si kampe, klube, sporte, debate, dhe shfaqje)

#### Qëllimi 3: Përmirësimi i shkollës dhe komunitetit

470 palë interesi

rritën pjesëmarrjen e tyre në veprimtari që mbështesnin shkollat e tyre, përmirësonin mësimin e gjuhës angleze, ose shfaqnin aftësi të përmirësuara si rrjedhojë e zhvillimit personal dhe/ose profesional.



Studentë duke festuar Ditën e Gjuhëve, Orikum 2016.



## Zhvillimi Komunitar dhe Organizativ

Në programin e Zhvillimit Komunitar dhe Organizativ, vullnetarët punojnë me agjenci mikpritëse lidhur me çështje si: Planifikimi urban, zhvillimi ekonomik, turistik, dhe organizativ, planifikimi strategjik, menaxhimi i informacionit, mobilizimi dhe afrimi me komunitetin, si dhe promovimi i përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen në komunitet.



Programi i Pjekjes dhe Sipërmarrjes së Femrave  
Kuçovë, 2016



Klubi i Ambasadorëve në Natyrë në Shijak lyejnë stolat  
Shijak, 2016

### Arritjet gjatë vitit 2016

#### Qëllimi 1. Zhvillimi Organizativ

235 njësi të  
qeverisjes vendore  
dhe Organizata  
joqeveritare

kanë përmirësuar proceset e tyre të planifikimit në: Deklaratat e vizionit dhe misionit, planin strategjik, planin operacional, planin e monitorimit dhe vlerësimit, dhe përfshirjen e palëve të interesit.

83 Organizata  
joqeveritare,  
bashki dhe biznese

kanë përmirësuar menaxhimin e brendshëm në fusha, si: procedurat dhe politikat e burimeve njerëzore, shpërndarja dhe transparenca e informacionit, menaxhimi i kohës, dhe vendimmarrja me pjesëmarrje.

301 bashki,  
Organizata  
joqeveritare,  
dhe grupe  
komunitare

kanë përmirësuar krijimin e projekteve, praktikat dhe proceset e menaxhimit, dhe mundësojnë prova që qytetarët janë të kënaqur me performancën.

251 Organizata  
joqeveritare:

përmirësuan imazhin publik, dhe promovimin e zonave historike, kulturore, dhe turistike nëpërmjet rritjes së numrit të vizitorëve, rritën aksesueshmërinë në informacionin dhe shërbimet e ofruara.

#### Qëllimi 2. Ndërtimi i shoqërisë civile

1614 persona:

u trajnuan në mbarë vendin për lidership.

260 persona:

u trajnuan për aftësitë për punësim, sipërmarrje, kurse të teknologjisë së informimit dhe komunikimit në mënyrë që të rriteshin mundësitë e të rinjve për t'u punësuar në tregun e punës.

1531 të rinj:

u trajnuan për vullnetarizëm dhe morën pjesë në veprimtari lidhur me shërbimet komunitare.

2500 të rinj:

u trajnuan në veprimtari në përfitim të komunitetit, si: Pastrimi i mjedisit, mbjellja e pemëve, kryerja e transportit të rrobave dhe ushqimit.

1092 persona:

u trajnuan për advokacinë dhe përfshinë 657 të rinj në planifikimin ose zbatimin e veprimtarive ose fushatave të advokacisë për të drejtat e fëmijëve/femrave/pakicave dhe personave me aftësi të kufizuara

## Edukimi shëndetësor

Vullnetarët caktohen në një komunitet dhe bashkëpunojnë në mësimin e edukimit shëndetësor në shkolla 9-vjeçare dhe/ose të mesme, ku ata japin informacion për aftësi jetësore dhe çështje të shëndetit riprodhues.



Panairi i Shëndetit në Komunitetit, në qarkun e Pukës, 2016



Trajnime për Shëndetin Amësor në qarkun e Fierit, 2016

## Arritjet gjatë vitit 2016

### Qëllimi 1: Shëndeti seksual dhe riprodhues

1485 të rinj

në Shqipëri kanë fituar njohuri dhe aftësi shoqërore për të shmangur shtatzënitë e hershme apo të paplanifikuara, si dhe për t'u kujdesur për shëndetin e tyre riprodhues.

367 mësues, psikologë, dhe mjekë

kanë përmirësuar aftësitë për të krijuar dhe mundësuar përmbajtje të përshtatshme me moshën për edukimin e shëndetit seksual dhe riprodhues, si dhe për promovimin e jetesës së shëndetshme.

### Qëllimi 2: Jetesë e shëndetshme dhe aftësi jetësore

5056 të rinj:

(nga klasa e 5 në të 12) kanë shfaqur përmirësim në një ose më shumë aftësi kyçe jetësore ku përfshihen vetëvlerësimi pozitiv, komunikimi i efektshëm, aftësia për të vendosur qëllime, të menduarit kritik, dhe krijimi i strategjive për të mbështetur shëndetin e tyre emocional dhe fizik.

4520 të rinj:

kanë fituar sjellje të shëndetshme lidhur me veprimtarinë seksuale, fizike, konsumin e alkoolit, dhe përdorimin e substancave.

2125 të rinj

promovuan aftësi jetësore dhe sjellje të shëndetshme nëpërmjet veprimtarive shkollore, edukimin e bashkëmoshatarëve, dhe teknikave të lidershipit.



## Përparësia e programit ndërsektorial

### Vajzat udhëheqin botën tonë me nismën “Lejojini Vajzat të Mësojnë”



Vajzat drejtojnë botën tonë, kampi në Kuçovë, 2016

#### Arritjet gjatë vitit 2016

Këtë vit, Vullnetarët në Shqipëri dhe Homologët shqiptarë drejtuan kampe të krijuara posaçërisht për vajza të reja që ato të kishin mundësinë të eksploronin tema të ndryshme, si: Liderhipi, puna në ekip, komunikimi, mjedisi, dhuna në familje, shëndeti seksual dhe riprodhues, dhe fuqizimi personal.



Projekti LAJ/Rinovimi i banjave në shkollë, Elbasan, 2016

Pjesëmarrësit e kampit drejtojnë veprimtari qytetare dhe trajnojnë vajzat e tjera të reja në komunitetet e tyre.



Kampi i vajzave për herë të parë në Roskovec, Roskovec, 2016

Përparësia e gjinisë përfshihet në tre programe ndërsektoriale të Korpusit të Paqes: Mësimi i Gjuhës Angleze, Zhvillimi komunitar dhe Organizativ, dhe Edukimi Shëndetësor. Nisma “Lejojini Vajzat të Mësojnë” ka ofruar burime për Vullnetarët dhe homologët e tyre, si dhe mundësi trajnimi.



## Grante të vogla



Trajnime për ndërgjegjësimin ndaj kancerit të gjirit, në Librazhd, 2016



Ndihma në Projektet e Vogla – i financuar nga Projekti i Çative të Gjelbra, në Tiranë, 2016



Ndihma në Projektet e Vogla – i financuar nga Programi i Pjekjes dhe Sipërmarrjes së Femrave, Kuçovë, 2016

### Arritjet e vitit 2016

Në vitin fiskal (VF) 2016, USAID/Shqipëri i mundësoi Korpusit të Paqes në Shqipëri fonde sipas Marrëveshjes së Programit të Agjencisë Pjesëmarrëse në Ndhimën për Projekte të Vogla (PAPA) midis Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimi Ndërkombëtar (USAID) dhe Korpusit të Paqes të Shteteve të Bashkuara.

Nisma “Lejojini Vajzat të Mësojnë”, dhe programi i Partneritetit me Korpusin e Paqes gjatashtu siguroi fonde për grante.

### Ndihma në projekte të vogla

\$40,033

7 projekte

3 trajnime

në fonde për Ndhimën në Projektet e Vogla u shpenzuan për 7 projekte në 7 komunitete. u zbatuan të përqendruara te Krijimi dhe Menaxhimi i Projektit u kryen për Vullnetarët dhe homologët e tyre shqiptarë.

### Programi i partneritetit me Korpusin e Paqes

Mbi \$12,000

3 projekte

u dhanë për programin e partneritetit me Korpusin e Paqes u krijuan dhe zbatuan në Durrës, Berat dhe Korçë.

### “Lejojini Vajzat të Mësojnë”

Mbi \$25,200

12 projekte

u dhanë për 12 projektet “Lejojini Vajzat të Mësojnë”.

u krijuan dhe zbatuan.

## Njohja e kulturës amerikane



Qoshja e anglishtes në Fier gjatë ditës së Halloween-it

### Traditat amerikane

Vullnetarët në mbarë vendin ndajnë traditat e tyre me shqiptarët.

Për t'u theksuar: Trupa prej dhjetë fëmijësh e qoshes së anglishtes në Fier mësuan për Halloween-in dhe u frymëzuan nga Dita e Falënderimeve në SHBA; të gjithë ndanë ato për të cilat ishin më mirënjohës dhe më pas i shtuan pendë një gjeli deti të madh, te vizatuar për Ditën e Falënderimeve. Trupa gjithashtu luajti disa lojëra dhe bëri "gjela deti" të ëmbël me biskota Oreo, karamela të buta, dhe gjevrekë.



Konkursi i Gërmëzimit në një nga shkollat e Libohovës

### Konkurse amerikane

Konkurset e Bletës Gërmëzuese në anglisht. Njëmbëdhjetë vullnetarë të Trupave të Paqes prezantuan 200 studentë në tre komunitete në mbarë vendin me "Bletët Gërmëzuese" amerikane.

Shumë studentë gjithashtu morën pjesë në një konkurs shkrimi të quajtur "Le të Shkruajmë!"

## Njohja e kulturës shqiptare



Nxënësit e një shkolle në Minneapolis të njohur me Shqipërinë, 2016

### Histori shqiptare

Vullnetarët e Korpunit të Paqes krijojnë lidhje midis klasave dhe studentëve në Shqipëri dhe klasave dhe studentëve në SHBA.

Për t'u theksuar: Një Vullnetare e Korpunit të Paqes në Shqipëri mori një pjesë të Shqipërisë me vete kur vizitoi qytetin e saj Minneapolis, Minnesota! Vullnetarja vizitoi një shkollë fillore në Minneapolis dhe iu foli fëmijëve për traditat dhe festat shqiptare, dëgjuan së bashku muzikë tradicionale, shfaqën flamurin shqiptar, panë lekun shqiptar (të gjithë morën monedha 1 lekëshe), dhe madje iu mësoi të hidhnin valle!





Vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Homologët e tyre, Pranverë 2016.

### **Nisma për përmirësimin e mbështetjes së vullnetarëve**

Konferenca me të gjithë vullnetarët: Për herë të parë, të gjithë vullnetarët u mbledhën për një gjysmë dite. Kevin McLaughlin, Kreu i Grupit për Planifikimin e Projekteve të Qeverisjes Vendore organizoi një diskutim me Bruna Kondin nga Tirana, Romina Hasanajn nga Librazhdi dhe Altin Veshti nga Tirana që reflektuan lidhur me ndikimin e marrëdhënieve që kishin pasur me Vullnetarët e Korpusit të Paqes të cilët kishin shërbyer në vitet e mëparshme. Vullnetarët gjithashtu dëgjuan kryetarin e bashkisë së Tiranës tek fliste për historinë e tij, angazhimin e tij ndaj shërbimit dhe vullnetarizmit, dhe vizionin e tij për qytetin e Tiranës.

Zhvillim i qëndrueshëm: Në vitin 2016, stafi nënvizoi zhvillimin e qëndrueshëm, dhe punoi për të thelluar ndikimin e tyre duke siguruar bashkëpunimin e Vullnetarëve të Korpusit të Paqes me Homologët shqiptarë.

Politikat e përmirësuara: Manuali i Shërbimit të Korpusit të Paqes në Shqipëri iu nënshtroi një shqyrtimi gjatë vitit 2016. Kjo gjë erdhi si rrjedhojë e bashkëpunimit të Komitetit Këshillues të Vullnetarëve në Shqipëri dhe anëtarëve të Stafit. Për ta qartësuar dhe lehtësuar leximin dhe kuptimin, rreth 25% prej politikave që gjendeshin në versionin e prillit të vitit 2015, u hoqën, gjë që solli zvogëlimin e madhësisë së manualit.



## Zhvillimi i vullnetarëve dhe stafit

### Trajnimi i Korpusit të Paqes për vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri

Vullnetarët e Korpusit të Paqes i nënshtrohen një procesi të gjerë trajnimi që nis me mbërritjen e tyre dhe vazhdon gjatë gjithë shërbimit të tyre. Në vitin 2016, Vullnetarë të Korpusit të Paqes morën pjesë në trajnimet e mëposhtme:

- Seancë orientimi – 3 ditë
- Trajnim para shërbimit - 10 javë
- Trajnim gjatë shërbimit -2 ditë
- Trajnim në mes të shërbimit - 2 ditë
- Workshop-e për menaxhimin e krijimit dhe menaxhimit të projektit – 3 ditë
- Konferencë me të gjithë vullnetarët - 1 ditë
- Trajnim për rrjetin e mbështetjes së kolegëve - 2 ditë
- Trajnim për Rifreskimin e Gjuhës për Vullnetarët 3 + ditë
- Konferenca për mbylljen e shërbimit -2 ditë



Trajnimi për Krijimin dhe Menaxhimin e Projektit, Tiranë



Vullnetari Michael gjatë një prezantimi

### Trajnimi i homologëve të Korpusit të Paqes

Në vitin 2016, profesionistë shqiptarë që shërbejnë si homologë të vullnetarëve tanë morën pjesë në 10 ditë trajnimi ku përfshihen:

- Trajnimi për krijimin dhe menaxhimin e projektit; 3 ditë
- Workshop-e me homologë; 2 ditë
- Trajnimi i trajnerëve të Vajzave Skautiste; 4 ditë



Trajnimi i homologëve të Korpusit të Paqes në Durrës

### Zhvillimi profesional i stafit të Korpusit të Paqes

Në vitin 2016, tetë anëtarë të Korpusit të Paqes në Shqipëri morën pjesë në 328 orë trajnim në Shtete të Bashkuara, Nepal, Kamboxhia, Gjeorgji dhe Tajlandë, duke u përqendruar në trajnime lidhur me:

- Mirëqenien mjekësore, shëndetësore, dhe emocionale - 120 orë
- Sigurinë dhe mbrojtjen - 80 orë
- Aspektet ndërkulturore - 40 orë
- Menaxhimin e granteve të vogla - 48 orë
- Trajnimin e trajnerëve për gjininë dhe aftësinë për punësim - 40 orë



Trajnimi i anëtarëve të stafit të Korpusit të Paqes në Shqipëri, Kamboxhia 2016



Aktiviteti i parë për Vajza Skautiste në Orikum, 2016



Shoqata Botërore e Guidave dhe Skauteve për Vajza me seli në Londër viziton Shqipërinë, 2016

Hilari dhe Mishela, dy ish pjesëtare të Vajzave skautiste që punojnë si vullnetare të Zhvillimit Organizativ të Komunitetit në Korpusin e Paqes, Shqipëri, filluan të bënin kërkime se si mund të bënin një prezantim të suksesshëm të Skauteve për Vajza në Shqipëri. Vullnetaret u lidhën me Shoqatën Botërore të Guidave dhe Skauteve për Vajza (WAGGGS), dhe kanë punuar për krijimin e një nisme të re dhe të qëndrueshme në Shqipëri.

Në gusht, Korpusi i Paqes, Shqipëri, mirëpriti tre anëtare të Shoqatës Botërore të Guidave dhe Skauteve për Vajza. Trajnimi, që përfshinte 12 vullnetarë të Trupave të Paqes, dhe 26 kolegë të tjerë, ishte krijuar për ta përgatitur grupin të hidhte në treg projektin Skautet për Vajza në Shqipëri. Trajnimi përqendrohej në edukimin e pjesëmarrësve për filozofinë e Skauteve për Vajza duke përfshirë traditën, këngët dhe praktikatat. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit u njohën me kurrikulën e Sipërmarrjes Shoqërore të Shoqatës Botërore të Guidave dhe Skauteve për Vajza. Kjo kurrikul do të përdoret për të gatë gjashtë muajve të ardhshëm në dhjetë qytete të ndryshme në të gjithë Shqipërinë. Një tjetër tipar i trajnimit ishte një aktivitet në natyrë për të zhvilluar fry-

mën e eksplorimit. Pjesëmarrësit mësuuan se si të ndiznin zjarrin dhe të ngrinin çadra. Në fund të trajnimit, grupet u kthyen në komunitetet e tyre përkatëse me plane vepërimi dhe burime për të nisur aktivitetin e trupave të tyre.

Në të gjithë Shqipërinë, u ngritën 15 trupa në 15 komunitete për vajzat e grup moshës 10-14 vjeç. Në këtë projekt po marrin pjesë 200 vajza nga Korça, Shkodra, Fieri, Rrësheni, Peshkopia, Vlora, Peqini, Berati dhe Kuçova në mënyrë tejet aktive.

Gjashtë liderë të vajzave nga të katra anët e vendit kanë dalë vullnetare për të udhëhequr Vajzat Skautiste në Shqipëri. Alketa (Keti) Lamani Dhimitri, Elsa Rafaeli, Kaltra Toska, Lusiana (Lusi) Mailaj, Manjola Gega dhe Marsela Saqellari janë në proces të regjistrimit të organizatës me Qeverinë e Shqipërisë dhe ndjekjen e anëtarësimit ndërkombëtar me WAGGGS. Frymëzuar nga Vullnetarët e Korpusit të Paqes, vajzat skautiste të Shqipërisë do të jenë plotësisht të mbështetur nën udhëheqjen e grave të pasionuara dhe të talentuara nga ky vend

Jemi tejet krenarë për të gjithë kampionët tanë!

## Kampet verore & Klubet pas mësimit



Mbajtja pastër e rrugëve, Orikum, Vlorë 2016

Në vitin 2016, ne Korpusin e Paqes në Shqipëri u përpoqën t'i përqendronin sërish Projektet Vullnetare Dytësore te kampet verore dhe klubet pas mësimit me kosto të ulët, ndikim të lartë, të përsëritshme dhe në rang vendor. Duke filluar me Trajnimin para Shërbimit për grupet me vullnetarë 19 vjeçarë, selia në Tiranë vuri në jetë strategjinë “Aftësimi për Jetën dhe Kampet e Lidershit për Klubet” teksa anëtarët e nismës “Lërimi vajzat të mësojnë” kontrollonin aktivitetin, duke i integruar elementët në çdo kuadër projekti.

Këtë vit, në Shqipëri janë ngritur kampe në mbi 46 vende me mbi 400 të rinj, ku u angazhuan në aktivitete nga më të ndryshmet duke përfshirë: Ambasadori i Natyrës, Sfida e Teknovacionit, Klubi i Anglishtes, Klubi Vajzat Drejtojnë Botën (GLOW), Klubi i Librit, Organizata Model e Kombeve të Bashkuara, Kampi Pa Emër, Aktivitete për formimin e ekipeve, Ndihma me Anglishten, Klubi i Artistëve të Vegjël, Klubi i Çiklizmit, Klubi “Gjej kuptimin”, Klubi i Vrapit, Klubi i Debatit, Ambasadorët e Natyrës, dhe Klubi i Krijimtarisë dhe të Menduarit Kritik për të Rinjtë.



### Pesë vjet “Panaire Shëndeti”

Në vitin 2012, Vullnetarët e Shëndetit të Korpunit të Paqes, Shqipëri, së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë organizuan Panaire Shëndeti që po zhvillohen edhe sot e kësaj dite pas pesë vjetësh. Sot, këto panaire organizohen në 51 komunitete.

Në bashkëpunim me autoritetet vendore si Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe shkollat në mbarë vendin, Vullnetarët e Korpunit të Paqes janë pjesë e komiteteve organizuese të panaireve në qendrat e qytezave me stenda individuale duke u përqendruar te çështje të veçanta që lidhen me shëndetin. Zakonisht, pjesë e këtyre panaireve bëhen edhe punonjësit e shëndetit nga zonat aty afër.

Stendat në panaire trajtonin tema si alkooli, drogat, duhani, siguria në rrugë, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, trafikimi i qenieve njerëzore, barazia dhe dhuna gjinore, shëndeti mendor, shëndeti i sistemit riprodhues dhe planifikimi familjar, tuberkulozi, ushqyerja, Treguesi i Masës Trupore (IMT-ja) dhe hipertensioni, si dhe higjiena e gojës. Gjithashtu, përfaqësuesit e Panairit të Shëndetit i ofrojnë fëmijëve kujdes falas për shikimin.

Komunitetet shfaqin mjaft interes dhe janë të etur për rekomandime, këshilla dhe sugjerime nga profesionistët e shëndetit. Panairët e shëndetit organizohen në shumë qytete të Shqipërisë duke përfshirë edhe ato ku nuk ka Vullnetarë të Korpunit të Paqes. Duke qenë se u ndërmor nga Vullnetarët e Korpunit të Paqes, kjo nismë është kthyer në një traditë të përvitshme.



Panairi i Shëndetit, Pukë 2016

## Tetë vite “Kampi Pa Emër”

Kampi Pa Emër u krijua në vitin 2008 kur njëri nga Vullnetarët e Korpusit të Paqes, Joseph Deschenes, së bashku me një qytetare nga Librazhdi, Alba Mana, vendosi të ngrinte një kamp një javor për fëmijët romë që jetonin rreth stacionit të trenit të qytetit në fjalë.

Në fillim, Kampi Pa Emër kishte katër këshilltarë dhe 20 fëmijë, por më pas u zgjerua në 70 fëmijë të menaxhuar nga 12 këshilltarë! Kampi nxit “tolerancën dhe rritjen personale të kampistëve dhe familjeve të tyre pavarësisht përkatësisë etnike”.

Qëllimi për çdo vit i Kampit Pa Emër është që të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës ku fëmijët romë dhe shqiptarë të mund të mësojnë dhe të rriten bashkë. Ditët kalojnë përmes të qeshurave dhe buzëqeshjeve teksa fëmijët bëjnë joga, hedhje disku, apo mësojnë arte dhe zanate. Në fund të ditës, fëmijët kërcëjnë të gjithë së

bashku këngë popullore shqiptare.

Gjithashtu, vitet e fundit, Kampi Pa Emër, ka filluar të përqendrohet te higjiena e gojës së kampistëve me mbështetjen e Zamir Allit, një dentist vendas. Pasi hanë mëngjes, të gjithë kampistët mbledhen për të larë dhëmbët dhe marrin këshilla të reja se si të kenë një buzëqeshje rrëzëllitëse.

Kampi Pa Emër, ishte edhe një ogur i mirë për Joseph-in dhe Albën pasi u martuan më vonë.

Dy vajza që filluan si kampiste që merrnin pjesë çdo verë në Kampin Pa Emër, kur u rritën u bënë këshilltare dhe sot janë “Motrat e mëdha” të komunitetit të tyre. Këto dy gra të reja janë një ndër arsyet se pse kampi është kaq i gjallë dhe funksionon kaq mirë çdo vit.

Plot hare, të qeshura dhe dhëmbë të shndritshëm, kampi mund të jetë i mbyllur deri verën e ardhshme, por pozitiviteti i tij do të vazhdojë përgjatë gjithë vitit!



Kampi “Pa Emër”, Librazhd, 2016



### Faqe interneti për Delvinën



Delvina është një qytezë piktoreske në Shqipërinë Jugore, 16 km larg Sarandës. Megjithatë, ajo shërben vetëm si pikë kalimi për turistët dhe vendasit që i drejtohen plazheve të Sarandës dhe Ksamilit, apo vendit arkeologjik të Butrintit.

Në pranverë të vitit 2016, u krijua një faqe e re interneti për të rritur numrin e turistëve që të shijonin bukurinë historike dhe natyrore të Delvinës. Gjatë përgatitjeve për sezonin e dyndjes së turistëve në Sarandë, Vullnetarët vendas të Trupave të Paqes dhe kolegët e tyre vendas krijuan një faqe të re interneti që nxjerr në pah mundësitë e shumta që ofrohen nëpërmjet vizitës së


monumenteve historike dhe shëtitjes më këmbë në Delvinë.

Ky projekt ishte krijuar nga Catherine Tuttle, mësuesja vullnetare e anglishtes, dhe kolegu i saj Marjo Kanina në një Konferencë për Menaxhimin e Krijimit të Projekteve të Korpusit të Paqes në janar të vitit 2016, e cila jep mësim të çmuara për aftësitë e menaxhimit të projekteve. Trajnimi i Menaxhimit të Krijimit të Projekteve financohet nga USAID-i në Shqipëri.

Për të vizituar faqen e internetit, klikoni këtu: <http://delvine.my-free.website>



### Vajzat në Tiranë konkurrojnë për sfidën Teknovacion



Në Shqipëri, vajzat shquhen si nxënese të mira, por edukimi i Teknologjisë së Informacionit mbetet ende një sfidë. Disa vajza shqiptare kanë telefona inteligjentë dhe shumë prej tyre mund të kenë një llogari në Facebook, por aksesit në burime në shumë pjesë të vendit mbetet ende sfidë më vete.

Ky është viti i parë që Vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë prezantuar Teknovacionin dhe klubet e teknologjisë për vajzat shqiptare.

Për 12 javë, dy ekipe me vajza nga Tirana punuan me një vullnetar nga Korpusi i Paqes dhe një vullnetare nga Ambasada amerikane duke marrë pjesë në Sfidën e Teknovacionit, një konkurs ndërkombëtar që i nxit ato të mësojnë më shumë për teknologjinë. Gjatë kësaj periudhe 12 javore, vajzat punuan për projektimin e aplikacioneve për telefonat inteligjentë, dhe hartuan një plan biznesi ku përshkruanin se si do të donin ta hidhnin në treg aplikacionin e tyre.

Ekipi me pesë gjimnazistë, zhvilloi një aplikacion që ofron burime të shëndetit mendor për adoleshentët përgjatë Shqipërisë. Aplikacioni ofron informacion në gjuhën shqipe rreth çështjeve të shëndetit mendor si dhe ofron informacion dhe udhëzime për burimet e disponueshme të shëndetit mendor në Shqipëri.

Ekipe të shkollave të mesme, të përbëra prej katër anëtarësh, iu përkushtuan turizmit dhe plazheve të Shqipërisë. Nëpërmjet të dhënave nga Ministria e Mjedisit, ata krijuan një aplikacion që i lejonte përdoruesve të kërkonin për plazhe afër qyteteve të ndryshme të Shqipërisë dhe ofron informacion për cilësinë e ujit krahas komoditëve që disponon secili prej tyre.

10 ekipe në 10 komunitete përgjatë vendit me 50 vajza gjithsej, raportuan se ishte një përvojë e vlefshme e të nxënësve. Disa prej tyre thanë se ishin të interesuara të bënin punë që lidhen me teknologjinë dhe që të kuptuarit se si teknologjia funksionon është diçka që të fuqizon.

### Projekti i Veterinarisë në Shkodër



Vullnetarja e Korpusit të Paqes Jessica bashkërendoi një klinikë veterinare me një duzinë komunitesh dhe vullnetarë të Korpusit të Paqes. Disa vullnetarë shkuan në qytetin e Shkodrës për të mbledhur kafshët e rrugës dhe për t'i çuar në një klinikë të përkohshme. Vullnetarë të tjerë e menaxhuan operacionin nga klinika ndërkohë që veterinerët punonin në disa salla të improvizuara operacioni. Në vitin 2016, në Shkodër, u vaksinuan dhe u trodhën 217 qen e mace nga gjashtë veterinerë të ftuar nga SHBA-ja

dhe vende të tjera të Organizatës Botërore të Veterinarisë.

Për vitin e ardhshëm, Jessica do të përqendrohet te qëndrueshmëria e projektit. Ajo kontaktoi me Dekanin e Fakultetit të Mjeksisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës për të mësuar se si klinika mund të shërbejë si praktikë për studentët e departamentit të Shkencave të Veterinarisë në Universitet. Planet e para u krijuan në vitin 2016, për të ndërtuar rrugën e suksesit në vitin 2017.



## Histori të veçanta: Një veprimtari e suksesshme me bazë shkollën

### Le të Shkruajmë! Konkursi i zhvilluar në Shqipëri



Nxënësit e Le të Shkruajmë në Belsh



Nxënësit e Le të Shkruajmë në Bicaj, Kukës



Nxënësit e Le të Shkruajmë në Pukë



Nxënësit e Le të Shkruajmë në Lushnjë


Këtë pranverë, rreth 1,000 persona nga 27 komunitete në të gjithë Shqipërinë duke filluar që nga nxënësit e klasës së gjashtë, e deri te studentët e universitetit, morën pjesë në konkursin e krijimit letrar Shkruaj! konkursi u zhvillua disa javë pas punës së nxënësve me mësueset e tyre të anglishtes dhe vullnetarët e Trupave të Paqes në klubet dhe workshop-et e të shkruarit.

Shkruaj! është një nismë ndërkombëtare e Korpusit të Paqes për zhvillimin e të rinjve, e cila synon promovimin e të menduarit kritik dhe të krijimtarisë në klasat

e anglishtes. Konkursi nënvizon “të menduarit përtej kornizave” për gramatikën dhe këtë vit, nxënësve iu kërkua të shkruanin rreth temave të ndryshme që i bënin ta shihnin jetën nga një këndvështrim tjetër, duke përfshirë edhe atë të gjinisë së kundërt. Këta nxënës të talentuar shprehën krijimtarinë e tyre duke shkruar për tema të zgjedhura posaçërisht për nivelin e tyre të të mësuarit.

Urime të gjithë nxënësve që morën pjesë, mësueseve të anglishtes dhe vullnetarëve që i frymëzuan ata çdo ditë!

### Projekti i ujit në Vehçan është një nga 10 të tillë të zbatuar gjatë 2016



Fshati i Vehçanit në Shqipërinë qendrore është një fshat i largët me shumë pak burime. Ky komunitet i vogël jeton në majë të një kodre dhe buzë një rruge me dhe. Në fshat ndodhet vetëm një shkollë dhe dy kafene të vogla.

Pas një vizite në shkollë, Kyle Moyes-it i ra menjëherë në sy gjendja e tualeteve. Nuk kishte ujë të rrjedhshëm që fëmijët të lanin duart. Pajisjet e tualetit të vetëm alla turka jashtë funksioni ishin të thyera dhe të papërdorshme. Duke qenë se fëmijët nuk kishin tualet, ishin të detyruar të shkonin në natyrë.

Ecuria e vërtetë e projektit erdhi pas një kohe të gjatë, dhe natyra e tij mund të përkojë me shprehjen tipike shqiptare “avash, avash”. Vullnetarët shkuan të pinin kafe me drejtorin dhe mësueset e shkollës për disa pasdite me radhë, pasi njohja më mirë e nevojave dhe personaliteteve të komunitetit ishte një aspekt tepër i rëndësishëm i këtij projekti.

Mbledhjet e komunitetit përgjatë pesë muajve, nën drejtimin e Kyle-it dhe kolegut të tij, Shpëtimin, ofruan mundësi për njohjen e shqetësimeve të komunitetit. Kyle-i së bashku me mbështetjen e komunitetit duke

përfshirë prindërit, infermierët vendas, Kryqin e Kuq vendas dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik Librazhd, organizoi një panair shëndeti që përqendrohej te mbajtja pastër e tualeteve, larja e duarve, larja e dhëmbëve dhe të ushqyerit shëndetshëm.

Të frymëzuar nga Panairi i Shëndetit, komuniteti punoi për mbledhjen e fondeve për ndërtimin e një tualeti të ri. Për këtë qëllim, u ofrua një grant, nëpërmjet të cilit u mundësua blerja e menjëhershme e pajisjeve të reja të tualetit, dhe pas dy javësh i gjithë rindërtimi përfundoi. Gjithashtu u vendosën tuba të reja për ujin e pijshëm, tualete të reja, dyer, tjegulla, lavamanë dhe pasqyra. Tani, tualetet janë mjediset më të mira në shkollë duke i ofruar djemve dhe vajzave mundësi që nuk i kishin pasur kurrë më parë. Tani, nxënësit mund të lajnë duart dhe vajzat nuk kanë pse të mungojnë më disa ditë në shkollë për shkak të kushteve të tualeteve dhe higjienike.

Komuniteti është thellësisht mirënjohës ndaj shoqatës Bamirësia e Ujit, Korpusit të Paqes dhe nismës Lëri-ni Vajzat të Mësojnë për mbështetjen që i dhanë kësaj mundësie. Kjo ishte një punë e vërtetë bashkëpunimi në komunitet që po fuqizon një brez të ri vajzash dhe djemsh.



## Vullnetarët dhe punonjësit që ofruan shërbimet e tyre në vitin 2016

### Vullnetarët e grupit 17

Allyson Stanford  
Annsleigh Carter  
Benjamin Dempe  
Bonnie Scott  
Charles McGee  
Charles Peterson  
Colby Kiener  
Corbin Kappler  
David Turner  
Emily Fesette  
Erich Klothen  
Ezra Monasebian  
Gene Kim  
Graham Anderson  
Jaclyn Boroff  
Jefferson Speer  
Jermanne Perry  
Jessica Asmus  
Jon Breen  
Jonathan Ayres  
Karla Yates  
Katie Littlejohn  
Kelsey Draughon  
Kevin Bawden  
Kristopher Parker  
Laura Hobbs  
Lauren Alpert  
Lucy Hamer  
Martin Fankhanel  
Meredith Porter  
Michael Keevican  
Monika Dunbar  
Olivia Grajeda  
Paulina Flores  
Quinn Hargitai  
Sho Tsubakiyama  
Stacey Weidemann  
Stephen Coryelle  
Teresa Anderson  
Thomas Pyke  
William Dunbar  
Zachary Blehm

### Vullnetarët e grupit 18

Ada Tran  
Adam Poeschl  
Adrian Horner  
Alexandra Schwier  
Alison Bregstein  
Alison Lozano  
Alyssa Harn  
Barbara Richardson  
Bonnie Rico  
Brian Bond  
Catherine Tuttle  
Christopher Vasquez  
Cristin Bleess  
Daniel Volkman  
Debra Thomas  
Diane Coon  
Erik Clark  
Francis Gavalier  
Gabriel Naranjo  
Grace Beah  
Hilary Richardson  
Jacob Farris  
Jacqueline Labrador  
Jesse Corfield  
Jessica Williams  
Joanne Luongo  
John Jaques  
Joseph Parks  
Julianne Scherer  
Justin VanLeeuwen  
Kyle Moye  
Md Ashique  
Megan Hamilton  
Michael Pugh  
Michael Winans  
Michelle Killingsworth  
Miles Killingsworth  
Mitesh Patel  
Nathan Boles  
Nicole Martin  
Paul Shawkat  
Pier Vernaza Varner  
Polly Smith  
Randolph Kent  
Ronald Lozano  
Sarah Senior  
Silke Martin  
Suzanne Weiss  
Thomas Cartaxo  
Walter Johnson  
William Burchell  
William Hunter  
William Martin  
Zachary James

### Vullnetarët e grupit 19

Alexandria Luu  
Amy Jacobi  
Angela Battisti  
Anthony Baker  
Barbara Grant  
Berta Schweinberger  
Brenna Moran  
Brittney Mancini  
Christine Torres  
Christopher Klimovitz  
Daniel Morton  
Dara Schmitt  
Dylan Saucedo  
Elizabeth Quimby  
Eric Williams  
Gillian Richter  
Jay Cederholm  
Jessica Skelton  
Jill Pearson  
John Clark  
Jordan Arvayo  
Joseph Otterbine  
Judith Glenn  
Julia Gross  
Julian Griffiee  
Julio Lamas  
Keith Jacobi  
Kelly Ancharski  
Keyania Campbell  
Lily Madeira  
Margret Chu  
Marilyn Matt  
Mary Surgi  
Megan Duffy  
Melanie Tafejian  
Michael McLemore  
Michael Richter  
Michelle Johnson  
Miguel Ramos  
Mike Bailey  
Oliver Powell  
Olivia Hanning  
Rachel Kennedy  
Ranya Agcaoili  
Raymond Edmondson  
Sarah Oswald  
Steven Hurtado  
Timothy Carroll  
Tina Racha  
Vincenzo Tanza  
Zachary Burdeau  
Zygmunt Czykieta

### Punonjësit me kohë të plotë të Korpusit të Paqes, Shqipëri

Agim Dyrmishi  
Alsida Myrtaj  
Anida Tulo  
Arben Cako  
Arben Loci  
Ardiana Brahja  
Besa Arapi  
Cale Wagner  
Darina Kaltani  
Diana Djaloshi  
Dritan Gjoshi  
Dritan Kamberi  
Elsona Cupi  
Gentian Leka  
Ilir Memlikaj  
Ilir Ziu  
Iris Dollia  
Iva Sinani  
Jason Kane  
Kate Becker  
Kenneth Johnson  
Marjeta Zavalani  
Marsela Loci  
Mira Luca  
Mirela Tahiraj  
Monika Mukja  
Poleta Luka  
Rudina Lubonja  
Ylli Cupi

### Punonjësit e përkohshëm të Korpusit të Paqes, Shqipëri

Ali Gjiriti  
Altina Peshkatari  
Ana Harja  
Besmira Rrumbullaku  
Brunilda Peqini  
Diamanta Vito  
Elona Kafexhiu (Pajova)  
Elvana Stambolli  
Erion Kumuria  
Ervin Bebeti  
Esmeralda Dogani  
Imelda Celibashi  
Ina Tollumi  
Ledion Veshi  
Marsida Rrupulli  
Ornela Bardhi  
Vjollca Merdani  
Ymer Leksi  
Zamir Mero  
Zerina Zeneli